



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.317/16

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Civil, e përbërë nga trupi gjykues, gjyqtari Besnik Bislimaj, si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi, anëtarë dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Merita Xharavina, në çështjen juridike të paditësit K. D. nga fshati K., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari B. H. av, nga Gjakova, kundër të paditurës V. D. (e lindur Gj.) nga fshati P. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson i autorizuari N. Gj. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, për zgjidhjen e martesës, në seancën jo publike për shqyrtimin kryesor të çështjes, të mbajtur me dt.28.04.2017 në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe të të autorizuarit të paditures, mori këtë:

A K T G J Y K I M

SHKURORËZOHET me marrëveshje martesë në mes të propozuesve K. D., i lindur me dt... në Gjakovë, dhe propozueses V. D. (e lindur Gj.) nga fshati K., Komuna e Gjakovës, e lindur me dt... në Gjakovë, e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në B., me dt..., me numër rendor 51, numri i referencës 2/2011RM/2011.

Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi K. D. nga fsh.K., Komuna e Gjakovës, me dt.22.06.2016, ka parashtruar përmes të autorizuarit të tij B. H. av, nga Gjakova, padi për zgjedhjen e martesës kundër të paditurës V. D. (e lindur Gj.) nga fshati P., Komuna e Gjakovës. Palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me dt..., palët ndërgjyqëse në fillim të martesës kishin raporte shumë të mira bashkëshortore, mirëpo, më pas ato raporte ftohen në minimum dhe në pamundësi të relaksimit. Martesa faktike tani më ka pushuar së ekzistuari. Rivendosja e saj është e pamundur. Nga kjo martesë qifti bashkëshortorë nuk kanë fëmijë dhe as që presin në të ardhmen.

Në shqyrtimin e dt.28.04.2017 i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i autorizuari i të paditurës janë pajtuar që këtë çështje ta zgjidhin me marrëveshje dhe padinë ta konsiderojmë si propozim.

Në bazë të deklarimeve të e mësipërme të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës personalisht. Gjykata në kuptim të nenit 68 par.4 të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës (i publikuar në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë nr. 4 e

datës 01.09.2004, në tekstin e mëtejme: LFK), Gjykata ka konsideruar se ndërgjyqësit kanë paraqitur propozim për shkurorëzim me marrëveshje.

Në shqyrtimin kryesor të datës 28.04.2017, i autorizuari i propozuesit B. H. av, nga Gjakova, ka deklaruar se martesë faktike ka pushuar gati me shumë se një vit, ish bashkëshortët kanë ndërprerë çdo kontakt në mes tyre. Kjo shkëputje e martesës është pasojë e mospërputhjes së karaktereve në mes tyre, dhe mbi këtë bazë kanë vendosur që këtë martesë ta zgjidhin me marrëveshje. Vlerësojmë se tani më janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për zgjidhjen e martesës. Nga kjo martesë propozuesit nuk kanë fëmijë dhe as që presin të kenë. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i propozuesit ka deklaruar se mbës në tërësi pranë të dhënave si në propozim ashtu edhe gjatë kësaj seance duke shtuar edhe njëherit se martesë faktike ka pushuar si pasojë e ftohjes në maksimum të raporteve në mes tyre, vlerësojmë se të gjitha kushtet ligjore që një martesë e tillë të zgjidhet me shkurorëzim. Propozoi gjykatës që propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës ta aprovoi si të bazuar.

Në shqyrtimin e dt.28.04.2017 i autorizuari i propozueses N. Gj. ka deklaruar se mbës në tërësi pranë propozimit të përbashkët për zgjidhje e martesës, theksoi se fillimisht raportet në mes bashkëshortëve kanë qenë të mira, por pas një kohe ato raporte janë përkeqësuar me masë sa që, jeta bashkëshortore është bërë e padurueshme, andaj, dhe propozuesit janë marr vesh dhe me vullnet e prishin këtë martesë, nga kjo martesë nuk kanë fëmijë dhe as që presin të kenë. I propozoi gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovoi propozimin në tërësi si të bazuar. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbës në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pas administrimit të provave konsideroi se janë plotësuar kushtet ligjore që kjo martesë të zgjidhet, theksoi edhe një herë se nga kjo martesë nuk kanë fëmijë as që presin të kenë, andaj, edhe i propozoi gjykatës që ta aprovoi propozimin në tërësi si të bazuar dhe të merr aktgjykim me të cilin martesën në mes propozuesve ta zgjidhe me shkurorëzim.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave, Gjykata ka bërë shikimin dhe leximin e çertifikatës së martesës nr.të ref.2/2011RM/2011 me nr. Rend.51 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë me dt.17.06.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave së lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se: Propozimi i propozuesve është i **bazuar**.

Nga leximi i çertifikatës së martesës me numër rendor 51, numër të referencës 2/2011RM/2011, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, e datës 17.06.2016, Gjykata e ka provuar faktin e lidhjes së martesës në mes të propozuesit K. D. nga fshati K., Komuna e Gjakovës, dhe propozueses V. D. (e lindur Gj.) nga fshati P. Komuna e Gjakovës.

Baza ligjore

Sipas nenit 68 par. 1 të të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës (i publikuar në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë nr. 4 e datës 01.09.2004, në tekstin e më tej: LFK) është e paraparë se “*martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës*”. Me par. 2 të këtij neni parashihet “*Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente*. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se “*bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në*

mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anshme”. Sipas nenit 84 par. 1 të LFK-së është paraparë se “kur procedura ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me anë të marrëveshjes së dy anshme, faktet në të cilat është mbështetur propozimi, nuk hetohen.”

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje është i bazuar dhe se i njëjti duhet të aprovohet në tërësi si i bazuar. Gjykata vlerëson se mbi bazën e të lartcekurave, e duke u nisur nga fakti se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për prishjen e kësaj martese, vendosi sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, përkatësisht martesën e këtij propozuesve e zgjidhi në pajtim me nenin 69 të LFK-së. Kjo ngase më dispozitat e LFK-së, është e paraparë se martesa lidhet me vullnetin e të dy palëve, e po ashtu mbajtja e saj, është e varur po ashtu nga vullneti i të dy palëve. Në bazë të provave të administruar në këtë procedurë, është vërtetuar fakti se raportet në mes të propozuesve gjatë jetës së tyre të përbashkët janë acaruar në mënyrë serioze dhe të përhershme aq sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, si rezultat i së cilës ata kanë ndarë martesën në mënyrë faktike dhe mbi një vit nuk jetojnë më së bashku, nuk kanë dhe as që presin të kenë fëmijë. Siç edhe u cek më lartë, kjo edhe ka qenë arsyeja që në këtë çështje kontestimore, ndër të tjera, fare nuk është zhvilluar procedura e tentimit të pajtimit të bashkëshortëve, e kjo duke u bazuar në nenin 76 par.1 pika (2) të LFK-së, andaj në bazë të të lartcekurave gjykata gjeti se propozimi i përbashkët i propozuesve është i bazuar dhe se i njëjti duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave, e duke u nisur nga fakti se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, gjykata nuk i hetoi faktet sa i përket shkaqeve të zgjidhjes së kësaj martese, andaj edhe martesën e zgjidhi në pajtim me nenin 68 par.2 të LFK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 457 të LPK-së

Nga sa u tha, e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68 dhe 69 të LFK-së, u vendos si më lartë.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

C.nr. 317/2017 të datës. 28.04.2017

**Sekretare juridike
Merita Xharavina**

**Kryetari i trupit gjykues:
Besnik Bislimaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, ky aktgjykim është i plotfuqishëm nga data 28.04.2017.